



Datë: 28.04.2025
Numër protokoli: 2852/2025

A.nr.355/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi Prenaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.355/2025, të datës 24.02.2025, të parashtruar nga ankuesja M.K., kundër organit të punësimit: Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 28.04.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.355/2025, të datës 24.02.2025, të parashtruar nga ankuesja, M.K.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbim civil M.K. (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), më datë 24.02.2025 përmes postës elektronike ankesa.kpmschck@rks-gov.net ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër refuzimit të aplikacionit në procedurën e rekrutimit me numër reference RN00015903, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, gjegjësisht për pozitën e punës “*Zyrtar i lartë për njohje (dhe barasvlerë) të kualifikimeve akademike dhe informim akademik*”, të shpallur nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, ndërsa, kjo e fundit, më datë 01.04.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se janë përmbushur kushtet për përfundim të procedimit administrativ të filluar sipas ankesës A.nr.355/2025, *sepse*:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit më datë 29.11.2024, ka shpallë Konkursin publik me numër reference RN00015903, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, respektivisht për pozitën “*Zyrtar i lartë për njohje (dhe barasvlerë) të kualifikimeve akademike dhe informim akademik*”, klasa e pozitës Profesional 1, Divizioni për Njohje dhe Informim Akademik-NARIC, i hapur për aplikim nga data 30.11.2024 deri më datë 29.12.2024.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë (72) kandidatë, ndër ta edhe ankuesja e cila sipas Njoftimit të datës 21.01.2025 të Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit, rezulton se nuk është përfshirë në listën e ngushtë, me arsyetimin se e njëjta me rastin e aplikimit nuk e ka bashkangjitur dëshminë që nuk ka ndonjë masë disiplinore në fuqi për shkelje të rëndë disiplinore në institucion publik apo deklaratën me shkrim të nënshkruar përmes së cilës dëshmohet se nuk ka masë disiplinore në fuqi sipas Ligjit për Zyrtarët Publik.

Divizioni i Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, më datë 11.02.2025, ka publikuar Njoftimin me Nr.12/2025 nga i cili njoftim rezulton se si kandidate e suksesshme për procedurën përkatëse është shpallur L.D. me 92.2 pikë.

Pas publikimit të Njoftimit me Nr.12/2025, të datës 11.02.2024 ankuesja brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kundërshtuar refuzimin e aplikacionit, nën supozimin se vërtetimi për masë disiplinore është bashkangjitur me rastin e aplikimit dhe i njëjti është dorëzuar brenda afatit ligjor. Kërkon nga Këshilli që të aprovoj ankesën si të bazuar.

Bazuar në të dhënat e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rezulton se kandidati P.K., si kandidatë aplikues në procedurën e rekrutimit me numër reference RN00015903, më datë 10.03.2025, kishte parashtruar në Këshill kundër procedurës së njëjtë, ndërsa, Këshilli me Vendimin me numër A.nr.435/2025, të datës 22.04.2025, ka anuluar Konkursin me numër reference RN00015903, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, gjegjësisht pozitën “Zyrtar i lartë për njohje (dhe barasvlerë) të kualifikimeve akademike dhe informim akademik” në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit si dhe çdo veprim tjetër që ka rrjedhë nga kjo procedurë e rekrutimit.

Andaj, referuar gjendjes se fakteve si më lartë dhe duke marrë parasysh se objekti i kontestit sipas ankesës A.nr.355/2025, të datës 24.02.2025, ka të bëjë me procedurën e pranimit për të cilën Këshilli ka vendosur në mënyrë meritorë me Vendimin A.nr.435/2025, të datës 10.03.2025, rrjedhimisht ka anuluar në tërësi procedurën e pranimit me numër reference RN00015903, si një qëllim i propozuar edhe nga ankuesja në petitumin e ankesës atëherë, mbi bazën e këtyre rrethanave, e në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilat është përcaktuar se: “Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot”. Kolegji vlerëson se objekti i ankesës A.nr.355/2025, është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje.

Kështu që, në mbështetje të nenit 8 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi që të përfundoj procedimin administrativ të filluar sipas ankesës A.nr.355/2025, të datës 24.02.2025.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Numri i lëndës: A.nr.355/2025

Datë: 28.04.2025

Numër protokolli: 2852/2025

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.355/2025

Kaltrina Avdullahi Prenaj

Ardita Haxhnikaj Demi

Procesmbajtëse

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses, M.K.;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.